

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2022

Lënda : Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj dt 24.08.2022 ardhur në postën elektronike :

Pyetje

Përshëndetje! Ju faleminderit për përgjigjen e pjesshme, por ne kërkojmë emrat e kompanive që kanë përfituar tenderet dhe për sa kohë janë fonde publike për kontrata publike, nuk ka asnjë bazë ligjore për të mbështetur qendrimin tuaj për kontratat pasi ato nuk janë sekrete dhe nuk përfshijnë çështje të sigurisë kombëtare.

Ne po kërkojmë informacion publik, për të cilin Koorporata Elektroenergjitike Shqiptare e ka detyrim ligjor të na e vendos në dispozicion.

Ne kemi nevojë për kontratat me emrat e kompanive pasi vetëm ato e sqarojnë koston shtesë, te cilat sipas KESH-it justifikojnë çmimin e lartë të energjisë elektrike.

Së fundmi, kemi kërkuar bilancet e vitit 2019 dhe 2020, por keni dërguar vetëm bilancin e 2019. Keni dërguar një letër që supozohet të jetë bilanci i 2020, por që nuk ka asnjë vulë të ekspertit kontabël dhe rrjedhimisht nuk mund të merret si dokument zyrtar ose i verifikueshëm.

Presim përgjigje për kontratat dhe për bilancet e vulosura, çdo kontratë që do të vijë pa emrin e kompanisë që ka marrë tenderin nuk quhet përgjigje për kërkesat tona.

Ankesa do të qendrojë në fuqi për të kërkuar mbështetjen e Komisionerit për të Drejtën e Informimit në rast se nuk ktheni përgjigje brenda afatit të fundit që ju ka ngelur.

Duke ju falenderuar,

Përgjigje sqaruese nga KESH sh.a. dt.09.09.2022:

Duke ju kërkuar se pari mirëkuptimin tuaj për trajtimin e kërkesës, si rrjedhojë e situatave dinamike të sektorit elektroenergjetik, ju lutem më poshtë të vlerësoni sqarimin e shoqërisë KESH në lidhje me kthimin e përgjigjes me anonimizim përsa I përket emrave të shoqërive tregtare që kanë marrë pjesë në procedurat e shitblerjes së energjisë elektrike.

Procedura e blerjes së energjisë elektrike e organizuar nga ana e shoqërisë KESH sh.a. konsiston në një garë e cila në përfundim të saj, shpallja e fituesve, publikohet rregullisht sipas formatit të publikimit për rezultatet e procedurës, duke shënuar cmim më të lartë, cmim më të ulët dhe cmim

të ponderuar të nergjisë së blerë apo shitur në se ka, sipas loteve të publikuara në ftesën për oferta, Dokument i cili edhe ky publikohet në faqen web të KESH sh.a.

Pjesëmarrësit për rezultatin e procedurës njoftohen nëse fitues ose jo fitues, individualisht në mënyrë të anonimizuar për të gjithë ofertat e dërguara për kërkesën e shpallur (me te njëjtën formë dhe përmbajtje si edhe ne kthimin e përgjigjes).

Pra përgjatë procesit asnjë prej pjesëmarrësve nuk njoftohet në lidhje me cili prej pjesëmarrësve të tjerë ka qënë fitues ose jo fitues, kjo për shkak se njohja e çmimit dhe sasisë së ofruar nga secili prej këtyre pjesëmarrësve mund të ndikojë në pozicionet tregtare të shoqërisë KESH e por në vecanti të secilit prej tyre në veprimtaritë e mëtejshme të tregtimit të varura nga shoqëria KESH sh.a., si tregu I kapacitetit apo tregu i brendshëm I furnizimit apo marrëdhënie të tjera tregtare.

Thënë këtë nga ana e shoqërisë si edhe në përgjigje nuk anonimizohet asnjë e dhënë sa I përket pjesës tregtare të transaksionit, por vetëm emri i entitetit i cili ka rrezultuar fitues me qëllim shmangien e efekteve në veprimtarinë e secilit pjesëmarrës dhe vetë shoqërisë, kjo edhe ne kontekstin e Ligjit për pronësinë Industriale dhe sekretit tregtar Ligji Nr. 96/2021.

Praktike e tillë e anonimizimit ndiqet gjerësisht në të gjithë tregjet e energjisë dhe tregjet e kapaciteteve (edhe transaksionet në bursë anonimizohen për te njëjtat arsye si përmendur më sipër) dhe një praktike ndryshe mund të ndikojë në shume aspekte sa i përket tregut të energjisë dhe procedurave që vete KESH realizon.

Megjithatë shoqëria ju bën me dije se një raport të detajuar të transaksioneve të shoqërive që operojnë në Republikën e Shqipërisë mund të gjendet në publikimet periodike të Entit rregullator të Energjisë.

Faleminderit!